

Reformat Urgjente Prioritare

Legjenda:

- realizuar
- nuk zbatohet ose masat e zbatuara janë në kundërshtim me prioritetin
- masat e zbatuara nuk janë në drejtim të plotësisht të prioritetit
- në rrjedhë e sipër

1. Sundimi i së drejtës dhe Gjyqësori

A. Gjyqësori



- Depolitizimi i emërimit dhe avancimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, jo vetëm në mënyrë teorike, por edhe në praktikë, në bazë të transparencës, kriterëve objektive, të bazuara në mënyrë rigorozë sipas meritës, të zbatuara me procedurë transparente dhe të hapur.
- Vendosja e sistemi të harmonizuar lidhur me menaxhimin e rezultateve të punës, bazuar edhe mbi standardet kualitative, përveç standardeve kuantitative, si bazë për të gjitha vendimet për karrierë
- Të shmangen ato elemente të sistemit për procedurat disiplinore dhe shkarkimin e gjyqtarëve, të cilët tani e cenojnë pavarësinë e gjyqësorit edhe në legjislacion edhe në praktikë..
- Të sigurohet profesionalizmi i Këshillit Gjyqësor, në praktikë, dhe jo vetëm në teori (përkatësisht, në mënyrë të qartë parashikohet testimi për zbatimin e obligimit ligjor për "jurist i shquar").
- Të rritet roli proaktiv i Këshillit Gjyqësor dhe i gjykatave më të larta, në mënyrë që gjyqtarët të mbrohen nga ndërhyrja në pavarësinë e tyre (përmes strategjive të përmirësuara të komunikimit dhe përmes veprimit të vendosur sipas ankesave për ndërhyrje ose presion)
- Të përmirësohet cilësia e trajnimit, buxhetit dhe autonomisë së Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (dhe të stimulohet dërgimi i gjyqtarëve nacional për fitimin e përvojës në GJEDNJ)
- Të sigurohet publikimi i të gjitha aktvendimeve gjyqësore në afate të qarta, të përcaktuara me ligj (dhe të sigurohen mundësi të plota për kërkim dhe qasje të lehtë)
- Të formohet dosje e suksesshme për kohëzgjatjen e përgjithshme të procedurave, me fokus të veçantë mbi "lëndët e vjetra"
- Të sigurohet ekzekutim i shpejtë i të gjitha aktvendimeve të GJEDNJ kundër shtetit (veçanërisht përmes zhvillimit të masave praktike dhe efektive për çdo kategori të lëndëve)



B. Mbikëqyrje funksionale gjyqësore dhe parlamentare mbi ndjekjen e komunikimeve

- Të sigurohet ndarje më e qartë e mandateve dhe akteve normative, të cilat kanë të bëjnë me ndjekjen e komunikimeve, nga njëra anë - për hetime penale, ndërsa nga ana tjetër - për qëllime të sigurisë
- Të evitohet funksioni ndërmjetësues i DSK si "gardian" i aktiviteteve të ndjekjes nga ana e organeve me autorizime të posaçme (policia, dogana, policia financiare)
- Të evitohet qasja e drejtpërdrejtë e DSK në pajisjen teknike, e cila mundëson ndjekjen e sinjalit të komunikimit të operatorëve të telekomunikacionit (për shembull, shmangia e plotë e aftësisë praktike dhe teknike e DSK për përfshirjen e
- Të sqarohet në ligj dhe në praktikë që operatorët e telekomunikimeve të guxojnë ta aktivizojnë dhe riorientojnë sinjale ndaj agjencive kompetente për zbatimin e ligjit (policia, dogana, policia financiare), ose agjencitë e sigurisë (DSK, Agjencia e Zbulimit dhe Shërbimi Ushtarak për Siguri dhe Zbulim pranë Ministrisë së Mbrojtjes) vetëm me pranimin paraprak të urdhrin relevant gjyqësor dhe vetëm për ndjekje ligjore
- Të instalohen mekanizma për menaxhimin me kriza për orientim dhe udhëheqje të të gjitha operacioneve të zbulimit, si dhe për sigurimin e përfunduar dhe arkivimin e të dhënave
- Të sigurohet trajnim adekuat i të punësuarve për mbrojtjen e të dhënave, të drejtave themelore, etikës profesionale dhe integritetit
- Të sigurohet mbledhje urgjente dhe e rregullt e komisioneve përkatëse parlamentare për ndjekjen e komunikimeve dhe për siguri dhe kundërzbulim, si dhe funksionimi papengësë i tyre
- Të sigurohet që këto komisione të funksionojnë në përputhje me detyrat e tyre ligjore për njoftim, si dhe t'u mundësohet papengësë t'i pranojnë të dhënat e nevojshme, dëshmitë, ndihmën teknike dhe qasjen, të domosdoshme për përgatitjen e



C. Organe të pavarura rregullatore, kontrolluese dhe mbikëqyrëse

- Të sigurohet autonomi e mjaftueshme e organeve rregullatore, kontrolluese dhe mbikëqyrëse, jo vetëm teorikisht, por edhe në praktikë, me qëllim që ato të veprojnë në mënyrë efektive dhe pa presione politike. Kjo kërkon jo vetëm angazhime proaktive nga vet organet, por edhe vullnet politik të të gjithë faktorëve të tjerë t'u lejojnë t'i kryejnë funksionet e tyre, siç parashikohet me ligj, përfshirë edhe përmes ndarjes së mjeteve të mjaftueshme financiare.
- Të sigurohet që anëtarësia në organet e pavarura rregullatore të themelohet mbi aftësitë profesionale, përvojën profesionale, konform fushës dhe përparësisë komparative gjatë zgjedhjes/emërimit
- Të sigurohet që të gjitha organet shtetërore t'i respektojnë rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe organeve të tjera këshillëdhënëse, me respektim të plotë të ligjit dhe parimit të llogaridhënies
- Të sigurohen sanskione efektive ligjore për mospërbushjen e kërkesave dhe rekomandimeve të organeve të pavarura
- Të sigurohet që Zyra e Avokatit të Popullit të rregullohet tërësisht në përputhje me Parimet e Parisit



Ç. Politikat anti-korrupsion dhe legjislacioni

- Të inkorporohet doje autentike për korrupsionin e nivelit të lartë, ashtu që organet të cilat e zbatojnë ligjin dhe organet mbikëqyrëse të kenë autonomi të mjaftueshme që të veprojnë të pavarura, në përputhje me ligjin (autenticiteti i dosjeve aktuale është çrregulluar për shkak të mungesës së një numri të caktuar të lëndëve të profilin të lartë nga vitet paraprak)
- Duhet të përforcohet lufta e përgjithshme kundër korrupsionit



Të përmirësohet kontrolli i deklaratave për konflikt të interesit dhe listave anketuese të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, përmes instalimit të Regjistrimit qendror të personave të këtuillë



Të punohet me ekspertë të GREKO në mënyrë që të instalohet një mekanizëm i ri gjithëpërfshirës për mbrojtjen e denoncuesve në përputhje me rekomandimet e fundit të Këshillit të Evropës dhe praktikat më të mira evropiane



E. Lustrimi



Të zgjidhen mangësitë serioze dhe të revidohet/tërhiqet Ligji për lustrim dhe zbatimin e tij (veçanërisht duke marrë parasysh mendimin amicus curiae të Komisionit të Venecias) sa i përket kufizimeve kohore, mbrojtjes nga motivet politike, ideologjike ose partiake, të cilat shfrytëzohen si baza për lustrim; përjashtimi i personave në pozita private ose gjysmë-private dhe mbrojtja më e fuqishme e identitetit të subjekteve deri në vendimin përfundimtar gjyqësor)



2. Depolitizimi i administratës publike



Në mënyrë strikte të zbatohet korniza e re ligjore, Ligji për nëpunës administrativë dhe Ligji për të punësuarit në sektorin publik, me respektim të plotë të parimeve të transparencës, meritës dhe përfaqësimit të drejtë



Politikat e punësimit duhet t'i ndjekin parimet e transparencës, meritës dhe përfaqësimit të drejtë në shërbimin publik, përmes procedurave transparente. Nuk duhet të ketë punësime të mëtutjeshme pa respektimin e rregullave



Të vihet moratorium Ligji për transformimin e punësimeve të përkohshme në pozita të përhershme, gjithnjë derisa parimi i meritës të respektohet tërësisht në procesin e transformimit



Të prezantohet numri i të gjithë nëpunësve të punësuar publik në të gjitha ministrinë qeveritare, agjencitë dhe organet e tjera, të ndara sipas sektorëve



3. Reforma zgjedhore



Të përfundojë reforma zgjedhore, në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR dhe të Komisionit të Venecias, përfshirë edhe rritjen e shtrirjes dhe mundësive për paraqitjen e kundërshtimeve dhe ankesave, duke siguruar ndarje të mjaftueshme midis aktiviteteve të shtetit dhe partive politike dhe sigurimin e qasjes dypartiake të organeve zgjedhore në të gjitha nivelet



Të bëhet revizioni i Listës së Zgjedhësve, në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR, të vlerësohet saktësia dhe gjithëpërfshirja e të dhënave të votuesve, veçanërisht sa i përket mundësisë së votuesve të dyfishtë; votuesve të regjistruar veç e veç me të dhëna nga letërnoftimi dhe të dhëna nga pasaporta; dhe adresave me numër të madh të votuesve të regjistruar. Të identifikohen fushat lidhur me përmirësimin e mundshëm të saktësisë së të dhënave të votuesve. Të revidohet



4. Zbatimi i rekomandimeve të Komisionit Anketues për ngjarjet e datës 24 dhjetor



Të zbatohen rekomandimet e Komisionit Anketues të vitit 2013 lidhur me përmirësimin e funksionimit të Kuvendit dhe shpërndarjen e punës së tij



5. Media: Liria e shprehjes

A. Servisi Publik Radiodifuziv

Të sigurohen prova të dukshme për reformat rrjedhëse në Servisin Publik Radiodifuziv në lidhje me politikën, organizimin, edukimin dhe redaktimin, të orientuara kah adresimi i kritikave të cilat në të kaluarën u manifestuan rregullisht lidhur me mungesën e pavarësisë, mungesën e raportimit të balancuar, si dhe sigurimin e përmbajtjeve informative të cilësisë së lartë

B. Reklamimi qeveritar

Të inkorporohen rregulla rrigoroze për reklamimin qeveritar, të bazuara mbi kritere transparente, objektive dhe jodiskriminuese

Të sigurohet transparencë e plotë e reklamimit qeveritar (jo vetëm në aspekt të shpenzimit të financave publike, por edhe në aspekt të marrësve dhe përmbajtjeve)

Të zhvillohet mekanizëm për shpalljet e pa-arkëtuara të servisit publik, të cilët janë me interes të mirfilltë publik

C. Qasja në informata

Të adresohen pengesat kryesore, me të cilat ballafaqohen gazetarët gjatë sigurimit të informatave publike (për shembull, mossauesi i organeve relevante për t'u përgjigjur kërkesave të shumta për informata, përdorimi i tepërt i paarsyeshëm i kategorisë "konfidenciale" për dokumentet të cilët nuk janë të natyrës së këtyllë)

Ç. Shpifja

Reduktimi i numrit të rasteve të shpifjes të cilat arrijnë deri në gjykata që duhet të arrihet përmes:

Revidimit të legjislacionit në mënyrë që të evitohen rastet e tipit "nder", "dinjitet" dhe "fyerje", të cilat ngrihen në bazë të përkufizimit ligjor të "fyerjes", ndërkaq bëjnë pjesë jashtë spektrit të fyerjes sipas nenit 10 të KEDNJ

Revidimit të rregullave procedurale, me qëllim të përjashtimit të rasteve të vogla dhe në vend të kësaj rritjes së shfrytëzimit të ndërmjetësimit për zgjidhjen e të njëjtave

Mbështjetjes dhe promovimit të shfrytëzimit më të madh të vetë-rregullimit, si alternativë për veprim gjyqësor

Garantimit dhe zbatimit, në nivel politik, i praktikimit të vetë-kufizimit përkatës nga ana e politikanëve dhe funksionarëve publikë, në mënyrë që të mos hapet procedurë për shpifje, në përputhje me parimet e GJEDNJ

Infografiku është i përbërë në bazë të ndiekjes të shqyrtimit të Reformave Urgjente Prioritare të Arjetit 23, në të cilën morën pjesë antarët e Arjetit në vijim:

